



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 16.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “D&T Group” sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, me Nr. të Prok: 632-20-1237-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “D&T Group” sh.p.k, e dt. 12.06.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, me Nr. të Prok: 632-20-1237-5-2-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 11.06.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 11.06.2020;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “D&T Group” sh.p.k, me datë 12.06.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, me Nr. të Prok: 632-20-1237-5-2-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 16.06.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Ju në sistem keni ofertuar si i vetëm, kurse dokumentet e prezantuara brenda ofertës kanë rezultuar se jeni konzorcium;

-Lista e kontratave –referencave ose certifikatave për kryerjen e punëve e prezantuar nga ju, nuk përmbush vlerën e kërkuar në dosjen e tenderit nga Autoriteti kontraktues, prandaj bazuar në nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së, oferta juaj refuzohet pa kërkuar informacione të mëtejshme;

-Sipas llogaritjeve të Autoritetit kontraktues, për 5(pesë) projekte e para , ju keni realizuar në vlerë prej 200.061,06€, kurse për projektin e gjashtë që keni prezantuar në listen e kontratave të realizuara (me “Noti -Beton), nuk ju kemi marrë për bazë sepse për të njëjtën , ju është kërkuar që në sqarimet shtesë për aktivitetet e prokurimit : “Shpella e Qirave në fshatin Gërqinë (rruga për ecje)” dhe “Ndërtimi dhe sanimi i urave “,të na prezantoni kontratën dhe transakcionin banker, të cilën gjë nuk e keni bërë;

- Nuk keni prezantuar diplomën për inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv.Sa I përket asaj se kemi mundur ta kërkojmë në sqarime shtesë, ju rikujtojmë se për aktivitetet e prokurimit : “Shpella e Qirave në fshatin Gërqinë (rruga për ecje)” dhe “Ndërtimi dhe sanimi i urave “, ju është kërkuar që në sqarimet shtesë të prezantoni diplomën për inxhinjerin në fjalë, por nuk e keni sjellë;

- Për qiramarrje të mjeteve- pajisjeve teknike, kontrata ka qenë e nënshkruar vetëm nga njëra palë. Që një kontratë të jetë valide, duhet të nënshkruhet nga të dy palët kontraktuese.

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik NNSH “Korben” i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunë